



## ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR NË KOMUNËN E PODUJEVËS DHE MITROVICËN E VERIUT - 29 nëntor 2020 VOTIMI PËRMES POSTËS

### Periudha e aplikimit/regjistrimit 30 tetor - 7 nëntor 2020

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës është duke bërë përgatitjet për organizimin e Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicën e Veriut më **29 nëntor 2020**.

Të gjithë qytetarët e komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut me të drejtë vote që, jetojnë jashtë vendit mund të aplikojnë për regjistrim për të votuar përmes postës.

Formularin për regjistrim për Votim Përmes Postës mund ta siguron nga:

- ✓ [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org), te linku: “Shërbimet për Votuesit”, pastaj linku: “Votimi Përmes Postës”;
- ✓ Linja ndihmëse e Operacionit të votimit përmes postës  
+ 383 38 213 100  
+ 383 38 213 200; dhe
- ✓ Ambasadat dhe konsullatat e Republikës së Kosovës.

Për ta fituar të drejtën e votimit përmes postës, ju duhet që:

- ✓ Të jeni nga mosha 18-vjeçare në ditën e votimit, më **29 nëntor 2020**;
- ✓ Të jeni shtetas i Republikës së Kosovës dhe të keni dokument të identifikimit të Republikës së Kosovës; dhe
- ✓ Të dëshmoni se keni të drejtë për t’u regjistruar në Regjistrin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacionet për votim përmes postës duhet të arrijnë në KQZ deri më **7 nëntor 2020**.

### Aplikacionin e plotësuar mund ta dërgoni:

- Përmes postës në adresë të KQZ-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Votimi Përmes Postës, K.P. 6, Kutia 351, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës;
- Përmes e-mailit zyrtar në njërën nga këta: [ovpp@kqz-ks.org](mailto:ovpp@kqz-ks.org) dhe [ogpp@kqz-ks.org](mailto:ogpp@kqz-ks.org); dhe
- Përmes faksit: + 383 38 213 200.

Nëse ju aplikoni për t’u regjistruar përmes e-mailit, aplikacionin tuaj duhet ta dërgoni vetëm për vete apo rrethin e ngushtë familjar, përmes postës elektronike personale (e-mailit).

Nëse dërgoni aplikacione për persona të tjerë, aplikacionet për regjistrim do të refuzohen!